

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ Departamenti i Pergjithshem-Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtesen Minire Krasniqi, ne ceshtjen e paditesit [REDACTED] me vendqendrim ne [REDACTED] [REDACTED] te cilin me autorizim e perfaqeson av. [REDACTED] nga [REDACTED], kundër te paditurëve [REDACTED] nga fshati [REDACTED] dhe [REDACTED] nga [REDACTED], ketë te fundit me autorizim e perfaqeson av [REDACTED] nga [REDACTED] për anulim kontrate, në seancën e mbajtur me datë 15.11.2013, në praninë e te autorizuarit te paditesit, te autorizuarit te te paditurit te dyte dhe ne mungese te te paditurit te pare, me datë 25.12.2013, ka marrë ketë:

AKT GJYKIM

APROVOHET kerkesepadia e paditesit [REDACTED] si e bazuar ne prova dhe ligj.

VËRTETOHET se kontrate e shiteblerjes së paluajtshmerisë e lidhur ne gjykatën komunale ne Ferizaj nen numrin Ve.nr.1756/07 date 02.05.2007, ne mes te [REDACTED] si shites, dhe [REDACTED] si bleres, eshte nule.

DETYROHET i padituri [REDACTED] nga [REDACTED] qe parcelat kadastrale numer 226, 230, 231 dhe 232 qe gjindet ne ZK [REDACTED], te regjistruara ne fletën poseduese numer 24, ne afat prej 15 ditësh nga plotëfuqishmeria e ketij aktgjykimi, t'i lirojë dhe dorëzojë ne posedim te qetë paditesit [REDACTED]

OBLIGOHET zyra kadastrale e komunës së Ferizajt, qe ne afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmerisë së ketij aktgjykimi te bëjë kthimin e gjendjes së mëparshme, qe ka ekzistuar para përmbarimit te kontratës së datës 02.05.2007 Ve.nr.1756/07, ne regjistrat kadastral, per sa i perket parcelave kadastrale nr.226,230,231 dhe 232 ZK Babushi Serb.

OBLIGOHEN paditurit qe paditesit t'ia paguajnë solidarisht paditesit shpenzimet e kësaj procedurë ne shumë prej 423.50€.

Arsyetimi

Paditesi permes te autorizuarit te tij, me padi dhe seancat e mbajtura ka pretenduar se paraardhësi i tij ka vdekur 21.03.1990, dhe se ne rastin konkret kontrata e shiteblerjes e lidhur kinse nga I autorizuari i babit tin [REDACTED] dhe [REDACTED], eshte falso sepse babi i paditesi nuk ka mundur objektivist te autorizoj askënd me datën 23.04.2007, sic eshte rpezxantuar autorizimi I tillë falso gjithashtu, andaj duke patur parasysh faktine tillë se babai i paditesi ka vdekur 17 vite para se te bëhej autorizimi nen numrin Vr.nr.1582/2007 dates 25.04.2007, kontrata e lidhur mbi bazën e ketij autorizimi eshte jorelae dhe e pavertet sepse nuk ka patur shprehje te vullnetit te pronarit ligjor per shiteblerjen e parcelave kontetsuese, adnaj kontrat e tillë duhet te deklarohet nule dhe i padituri i dyte te liroje pronën duek ia dorëzuar paditesit ne posedim.

I padituri i pare, ne deklarimet e tij si palë ndërgjyqjese po edhe ato te dhëna ne cilësinë e dëshmitarit ka sqaruar se ai nuk ka patur dijeni për vërtetësinë e autorizimit Vr.nr.1582/07 date

25.04.2007 duke theksuar se të njetit e kishte pranuar nga personi i quajtur [REDACTED] nga [REDACTED] të cilit person gjithashtu ia ka dorezuar shumën e cimit kontraktues 50 apo 55,000.00€.

I padituri i dytë, përmes të autorizuarit të tij, në përgjithësi në padi dhe seancat e mbajtura, ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë e paditësit duke shtuar se për pronën objekt kontesti ka paguar cimin kontraktues të autorizuarit të shitesit [REDACTED] dhe se që nga ajo kohë është regjistruar si pronar i parcelave kontestuese si dhe është në shfrytëzim të qetë të tyre.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushën detyrimin e tyre, për t'i parashtruar të njëjtat në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, administroi porvta si vijojnë:

Felta poseduese numer 24 date 24.04.2007 leshuar në emër të [REDACTED], aktvednimi I GJK Ferizaj T.nr.14/93 date të palexuar, autorizimi Vr.nr.1582/07 date 25.04.2007, certifikata e vdekjes date 04.03.1993 për [REDACTED] deklarat e deshmitarit [REDACTED] dhene në seance e dates 18.09.2013, certifikata e vdekjes se [REDACTED] dhe [REDACTED], kopja e librit të vërtetimeve të GJK Lipjan, për rubriken Vr.nr.1582/07 date 19.04.2007.

Gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit që u bëri provave vec e vec si dhe të ndërlidhura e varura reciprokisht në mes veti, këtë mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Gjykata ka gjetur si fakte kontestuese në mes palëve faktin nëse autorizimi i datës Ve.nr.1582/07 datë 25.04.2007 është i vërtet, faktin se me rastin e lidhjes së kontratës së shitëblerjes Ve.nr.1756/07 date 02.05.2007 a ka ekzistuar vullneti i pronarit për shitjen e parcelave kontestuese dhe se a është bërë ndonjë pagesë nga i padituri i dytë, për këtë shitëblerje dhe kujt i është bërë.

Faktet tjera të çështjes gjykata i ka konsideruar si jokontesstuese për çështjen.

Gjykata, ka vërtetuar faktin se autorizimi Vr.nr.1582/07 i datës 25.04.2007, kinse i vërtetuar në gjykatën komunale në Lipjan, është i pavërtet dhe i falsifikuar e si i tillë ka qenë i pavlefshëm dhe nuk ka mundur të krijoj kurrfar pasoja juridike, për çfarëdo vepërimi që është ndërmarr në legjitimitimin e saj. Këtë fakt gjykata e vërtetoi duke patur parasyh rrethanen-faktin se parardhësi i paditësit [REDACTED], i prezantuar si autorizimdhënës, në autorizimin e datës 25.04.2007, ka vdekur me datë 21.03.1990 dhe i njëjti objektivisht nuk ka mundur të autorizoj askend.

Në anën tjetër gjykata ka vërtetuar se autorizimi në fjalë është i pavërtet dhe i falsifikuar edhe mbi bazën e provës së prezantuar librit të vërtetimeve të gjykatës komunale të Lipjanit kun ë rubrikën nën numrin e autorizimit Vr.nr.1582/07 figurojnë emir dhe mbiemri i dy personave tjerë ([REDACTED] dhe [REDACTED]) të cilët kanë vërtetuar document tjetër prane kesaj gjykate me date 19.04.2007.

Gjykata, meq ka gjetur si të vërtetuar faktin se autorizimi Ve.nr.1582/07 i datës 25.04.2007 është i falsifikuar, vlerëson se gjendja e tillë e fakteve implikon detyrimisht edhe faktin se kontrata e shitëblerjes ve.nr.1756/07 datë 02.05.2007, është përmbyllur nën veprime mashtruese dhe të falsifikuara, kinse të të autorizuarit të të ndjerit [REDACTED], [REDACTED], andaj, meqenëse në rastin konkret, nuk ka ekzistuar vullneti i pronarit [REDACTED], për shitjen e pronave objekt kontesti, por se

transakcioni i kësaj prone nga pronari i vërtet në të paditurin e dytë, ka kaluar mbi bazën e veprimeve dhe dokumentacionit të kundërligjshëm-falsifikuar, në kundërshtim me rregullat e detyrueshme, gjykata bazuar në nenin 103 të LMD-së (GZ nr.29 date 26.05.1978), ka gjetur se kontrata e shitëblerjes Vr.nr.1756/07 dates 02.05.2007 e lidhur në mes të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], duhet anuluar dhe të gjitha pasojat e krijuara nga e njëjta, duhet restituohet-rivendosen, sikur kanë ekzistuar para lidhjes së kësaj kontrate.

Pra, paditesi në këtë procedurë ka arritur të provojë faktin se autorizimi Vr.nr.1756/07 date 02.05.2007 është i falsifikuar, faktin se i padituri i parë [REDAKTUAR], në mënyrë të rrjeshme është paraqitur si i autorizuar i paraardhësit të paditësit - [REDAKTUAR], meqë i njëjti kishte ndërruar jetë në vitin 1990 dhe se nuk ka ekzistuar asnjëherë vullneti i tij si pronar i pronës kontetsuese, për shitjen e pronës së tij, se kontrata e shitëblerjes është përmbjllur me veprimet e kundërligjshme të paditurit të parë [REDAKTUAR] kur ka përdorur autorizimin e falsifikuar, ndaj në rastin konkret kontrata e shitëblerjes në fakt nuk ka mund të quhet e lidhur meqë në rastin konkret nuk ka patur deklarim të vullneteve të palëve dhe rrjedhimisht nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 26 dhe 28 të LMD, që kontrata në fjale të prodhojë efektet e saja, ndaj si e tillë kontrata në fjale ka qene pa efekt që nga fillimi (ex nunc).

Gjykates nuk i është bërë i besueshëm në prova pretendimi se i padituri i dytë ka paguar ndonje shume në emer të cmimit kontraktues ndonjë personi lidhur me këtë shitëblerje, detyre kjo që rregulli i barrës së provave ia ngarkonte atij. Lidhur me këtë gjykata kosnideron se i padituri i dytë detyrimisht do të duhej të prezantonte gjykatës dëshmi material, për pagesën e cmimit kontraktues sikur në të vërtet do të kishte paguar për një gjë të tillë, ndonëse vërtetimi i këtij fakti nuk është me relevancë për të vendosur ndryshe këtë çështje.

Gjykata vlerëson se provat tjera nuk kanë ndonjë ndikim për të dhënë vlerësime ndryshe për kualifikimin e fakteve të çështjes.

Meqenëse të paditurit kanë humbur kontesin në këtë çështjes gjykata i obligoi të njetit, në kuptim të nenit 452.1 të LPK-se, që solidarisht t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës paditësit në shume prej 423.50€ , dhe ate për tri séance të mbajtura ngj121.00€ dhe nje séance të shtyre në shume prej 60.50€.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Republika e Kosovës  Republika C.nr.334/13 date 25.12.2013

SAKTËSIWË E KOSOVËS E VËRTETËSON
TAČNOST OTPRÁVKA POTVRĐUJE

Gjyqtari,

Enes Mehmeti




Prindori i autorizuar
Gjykatari rasnik



Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS



CA.nv. 633/2017